

VENDIM
Nr. 21, datë 9.1.2013

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
BASHKISË RUBIK TË QARKUT TË LEZHËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Rubik, të qarkut të Lezhës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 177 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1327 (një mijë e treqind e njëzet e shtatë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Rubik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1 (Pa ndërtesën private)	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative.	Në pronësi
2 – 36 (të mos transferohet pjesa private e pronës nr.2.)	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
37 – 44	Prona që përdoren për realizimin e programeve të shëndetit publik.	Në pronësi
45 – 47	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social- kulturore e sportive.	Në pronësi
48	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive në fushën e shërbimeve sociale.	Në pronësi
53 – 55	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehim dhe mbrojtje civile.	Në pronësi
56,189 – 199,201 – 203	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
204 - 212	Varrezat publike.	Në pronësi
213-219,229-233,237-244,246-247,251-255,257,259-466,468-491,497-530,532-543,545- 548, 1272-1322,1326-1327	Infrastrukturë (Sheshe, lulishte dhe shërbime publike.)	Në pronësi
467,493 – 496,531,1325	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
1131–1132,1136-1137,1141-1143,1147-1148,1151,1155, 1159-1160,1164-1166,1170-1172,1175,1178-1180,1184, 1185	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
1133-1135,1138-1140,1144-1146,1149-1150,1152-1154, 1156-1158,1161-1163,1167-1169,1173-1174,1176,1177, 1181-1183,1186,1187,1255-1271	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka jo produktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
1229-1254,1323,1324	Infrastrukturë (Rrugë vendore).	Në pronësi